



IOM International Organization for Migration
ONM Organizata Ndërkombëtare për Migracionin

PAKETË INFORMUESE PËR MBRETËRINË E BASHKUAR

1. Informacioni bazë

Kryeqyteti:	Londër
Popullsia:	60,245,000
Sipërfaqja total:	242,514 km ²
Gjuha:	anglisht
Monedha:	Sterlina (GBP)
Niveli i Papunësisë:	5.0%

2. Kushtet e përgjithshme të hyrjes dhe qëndrimit

Leje hyrjeje

Nëse ju duhet të aplikoni për leje hyrjeje kjo do të varet nga kombësia juaj dhe qëllimi juaj i vizitës në Mbretërinë e Bashkuar. Shërbimet e Vizave në MB kanë një formular për kërkesë për vizë në faqen e tyre të internetit që mund të përdoret për të përcaktuar nëse ju duhet vizë apo çfarë lloje leje nevojitet për të ardhur në Mbretërinë e Bashkuar.

<http://www.ukvisas.gov.uk/en/aboutus/enquiries/contactus>

Shtetasit e Shqipërisë, Bosnjë Hercegovinë, Ish Republikës Jugosllave të Maqedonisë, Malit të Zi dhe Serbisë kanë nevojë për vizë që të hyjnë në MB.

Për të bërë një aplikim për vizë (leje hyrjeje) në ambasadën ose konsullatën britanike, do të duhet të përdorni formularin VAF1- shkarkoni nga <http://www.ukvisas.gov.uk/resources/en/docs/1903073/vaf1>

Mund të aplikoni dhe online duke përdorur faqet e mëposhtme të internetit:

Shqipëria:

<http://www.britishembassy.gov.uk/servlet/Front?pagename=OpenMarket/Xcelerate/ShowPage&c=Page&cid=1050510483373>

Bosnja & Hercegovina

<http://www.britishembassy.gov.uk/servlet/Front?pagename=OpenMarket/Xcelerate/ShowPage&c=Page&cid=1106661028697>

Ish Republika Jugosllave e Maqedonisë:

<http://www.britishembassy.gov.uk/servlet/Front?pagename=OpenMarket/Xcelerate/ShowPage&c=Page&cid=1047661274821>

Kroacia, Mali i Zi, Serbia <https://www.visainfoservices.com/Pages/Welcome.aspx>

Kjo paketë informuese u përgatit në kuadër të projektit AENEAS 2006: Ndërtimi i Kapaciteteve, Informacion dhe Ndërgjegjësim për Promovimin e Migracionit të Rregullt në Ballkanin Perëndimor të financuar nga Bashkimi Europian dhe të bashkë-financuar nga Zyra Federale Zvicerane për Migracionin, Zyra Federale Gjermane për Migracionin dhe Refugjatët, Ministria Italiane e Punëve të Jashtme/Bashkëpunimi Italian për Zhvillim dhe Qeveria e Lihtenshtejn.



Schweizerische Eidgenossenschaft
Confédération suisse
Confederazione Svizzera
Confederaziun svizra



Federal Office
for Migration
and Refugees



Kualifikimi

Për të ardhur në Mbretërinë e Bashkuar si vizitor duhet të jeni në gjendje të tregoni që:

- doni vetëm të vizitoni Mbretërinë e Bashkuar deri në gjashtë muaj;
- planifikoni të largoheni nga Mbretëria e Bashkuar në fund të vizitës;
- keni para të mjaftueshme për të mbështetur dhe akomoduar veten pa punuar, pa ndihmë nga fondet publike ose që do të mbështeteni dhe akomodoheni nga të afërmit ose miqtë;
- nuk synoni t'u vendosni detyrime anëtarëve të publikut për shërbime të ofruara ose të mira të marra;
- nuk synoni të studioni; dhe
- mund të përballoni koston e kthimit ose udhëtimit të mëtejshëm

Nëse gjatë vizitës doni të bëni dhe biznes duhet të tregoni gjithashtu që ju:

- Normalisht jetoni dhe punoni jashtë dhe nuk keni plane për t'u vendosur në Mbretërinë e Bashkuar; dhe
- Nuk planifikoni të punoni, prodhoni të mira ose të ofroni shërbime në Mbretërinë e Bashkuar

Dokumentet e nevojshme

- një letër nga punëdhënësi që ju jep leje për mungesën nga puna për një periudhë të specifikuar. Letra duhet të thotë sa kohë keni qenë i punësuar nga ai punëdhënës, pozicionin dhe duhet të tregojnë kur pritet që të ktheheni në punë;
- nëse jeni i vetëpunësuar, vërtetim të veprimtarive tuaja të biznesit dhe gjendjes financiare;
- vërtetim të pronës që keni në vendin e origjinës;
- nëse jeni student, një letër nga shkolla kolegji juaj që përcakton në cilin kurs jeni, datat e tij të fillimit dhe mbarimit dhe data e periudhës së pushimeve që synoni të vizitoni Mbretërinë e Bashkuar;
- ndihmon gjithashtu nëse mund të tregoni lidhje familjare apo sociale dhe përgjegjësi për t'u kthyer;
- vërtetim të planeve të vendosura të udhëtimit që keni bërë;
- deklaratë bankare që përfshin një periudhë prej disa muajsh; dhe
- Vërtetim të kursimeve që keni në dispozicion.

Një aplikim për leje hyrjeje si vizitor mund të bëhet në çdo postë diplomatike britanike që ofron shërbimin e vizave. Të gjitha aplikimet e tjera për leje hyrjeje duhet të bëhen në postën diplomatike britanike në vendin ose territorin ku keni jetuar. Për postat diplomatike britanike në vendin tuaj shihni më poshtë.

Kohëzgjatja e qëndrimit

Nëse vini në Mbretërinë e Bashkuar si vizitor ju lejohet të qëndroni për një periudhë maksimale prej gjashtë muajsh. Nëse do t'ju jepej leje për të hyrë për tre muaj (kjo do të vuloset në pasaportën tuaj) dhe do të donit të shtynit qëndrimin në maksimumi gjashtë muaj, do të duhet të aplikoni duke përdorur formularin FLR (O). Duhet të dërgoni formularin e plotësuar të aplikimit me postë përpara se të mbarojë leja për të qëndruar. Formulari i aplikimit ju jep detaje se ku të dërgoni formularin e plotësuar, tarifën dhe dokumentet shoqëruese. Të gjithë dokumentet duhet të jenë origjinale përveçse kur keni arsye të forta pse nuk mund t'i siguronit me aplikimin.

Me një vizë vizitori nuk mund

- të filloni punë të paguar apo të papaguar
- prodhoni të mira apo të ofroni shërbime në MB, ose
- të shisni të mira dhe shërbime për publikun

Faqe interneti të nevojshme për çështjet e hyrjes dhe vizave

Zyra e Jashtme dhe e Komunelthit (FCO)	Shërbimet konsullore Numër telefoni për urgjenca 24 orë: 020 7008 1500	
	http://www.fco.gov.uk/en/about-the-fco/embassies-and-posts/	Lista e postave diplomatike britanike: kontakte

	http://www.fco.gov.uk/en/about-the-fco/what-we-do/building-strong-relationships-ol/foreign-embassies-in-uk/	Ambasada të huaja në MB
Agjencia Kufitare e MB	http://www.ukba.homeoffice.gov.uk/visitingtheuk/Enteringtheuk/en/tryclearance/	Informacion për pyetje për vizat, aplikime etj.
	http://www.ukba.homeoffice.gov.uk/policyandlaw/immigrationlaw/immigrationrules/appendix1/	Shtojca 1 – Lista e vendeve që kanë nevojë për vizë për Mbretërinë e Bashkuar
	http://www.ukba.homeoffice.gov.uk/visitingtheuk/passingthroughtheuk/documents/transitwithoutvisa/	Lista e vendeve për të cilat nuk vlen viza transit pa leje për vizë
	http://www.ukvisas.gov.uk/en/aboutus/enquiries/contactus	Formular i pyetjeve për vizë
	Nëse jeni jashtë MB, ju lutemi të kontaktoni qendrën e aplikimeve për vizë : Formular aplikimi: (+44) (0)20 7008 8308 Textfon: +44 (0)20 7008 8457	
Shërbimet e Vizave MB	Shërbimet e Vizës në MB, Zyra e Jashtme dhe e Komunelthit King Charles Street, London, SW1A 2AH. Tel.: 0845 010 5555	Nëse jeni jashtë Mbretërisë së Bashkuar duhet të kontaktoni postën më të afërt diplomatike.
	http://www.ukvisas.gov.uk/en/	Informacion për aplikantët për vizë
	http://www.ukvisas.gov.uk/resources/en/docs/1903073/vaf1 http://www.ukvisas.gov.uk/resources/en/docs/1903073/vaf1guide	Formular aplikimi (VAF1): Vizë vizitori

Ambasada britanike në Shqipëri

Rruga Skenderbeg 12

Tirana

Telefon: (355) 4 223 4973/4/5

Fax: (355) 4 224 7697

Faqe interneti: <http://www.britishembassy.gov.uk/albania>

Ambasada britanike në Bosnjë & Hercegovinë

Sarajevë

Tina Ujevica 8: HMA, Chancery/Management

Petrakijina 11: Visa, Consular, Commercial, DFID and Press sections

Operatori kryesor: (387) 33 282 200

Telefon: (387) 33 282 200 Chancery/Management

(387) 33 204 781/2/3 Commercial/DfID/Consular/Visa

Fax: (387 33) (28) 2203 Chancery/Management

(387 33) (20) 4780 Commercial/DfID/Consular/Visa

Email: ConsularEnquiries.sarajevo@fco.gov.uk

Email: VisaEnquiries.sarajevo@fco.gov.uk

Faqe interneti: <http://www.britishembassy.gov.uk/bih>

Banja Luka

Simeuna Dzaka 8

Operatori kryesor: (387) 51 212 395/216 842

Telefon: (387) 51 212 395/216 842

(387) 65 512 698 (Mobile)

Fax: (387) 51 216 842

Email: sarajevoBLOffice.sarajevo@fco.gov.uk

Ambasada britanike në Kroaci

Ivana Lucica 4, 10000 Zagreb

Tel: (385)(1) 6009 100
(385)(1) 6009 122 Viza & Konsullore
Fax: (385)(1) 6009 111 Ambasada Britanike
(385)(1) 6009 298 Viza & Konsullore
Email: Zagreb.visaenquiries@fco.gov.uk
Faqe interneti: <http://www.britishembassy.gov.uk/croatia>

Ambasada britanike në Kosovë
Ismail Qemajli 6, Arberi, Dragodan, Pristina
Telephone: (381) (38) 249 559
Fax: (381) (38) 249 799
Email: <mailto:britishembassy.pristina@fco.gov.uk>

Ambasada britanike në ish Republikën Jugosllave të Maqedonisë
Salvador Aljende No. 73, Skopje 1000
Telefon: (00) (389) (2) 3299 299
Fax: (00) (389) (2) 3179 729
(00) (389) (2) 3179 726 Konsullore/Viza
Email: Consular.Skopje@fco.gov.uk
Faqe interneti: <http://www.britishembassy.gov.uk/macedonia>

Ambasada britanike në Malin e Zi
Bulevar Svetog Petra Cetinjskog 149, First Floor, No.3, 81000 Podgorica
Telephone: (382) (81) 205 460
Fax: (382) (81) 205 441
Email: podgorica@britishembassy.cg.yu
Faqe interneti: <http://www.britishembassy.gov.uk/montenegro>

Ambasada britanike në Serbi
Resavska 46, 11000 Belgrade
Operatori kryesor: (381) (11) 2645 055
Telefon: (381) (11) 2645 055
(381) (11) 3615 660
(381) (11) 3060 900
Fax: (381) (11) 2659 651
(381) (11) 3061 089 Chancery
(381) (11) 3061 072 Konsullore/Viza
(381) (11) 3061 059 Tregtare
(381) (11) 3061 077 (Informacion)
Faqe interneti: <http://www.britishembassy.gov.uk/serbiaandmontenegro>

3. Imigracioni për qëllime punësimi

a. Kushtet e hyrjes dhe qëndrimit të punëtorëve të huaj

Në Mbretërinë e Bashkuar ekzistojnë skema të ndryshme për punë për kategori të ndryshme të punëtorëve që duan të marrin leje pune. }do kategori ka kërkesa të ndryshme kualifikimi me synim për të rregulluar migracionin për punë dhe për të plotësuar boshllëqet e mangësive në MB.

1) Leje pune

Mbretëria e Bashkuar është pjesë e Zonës Ekonomike Europiane (ZEE). Shtetasit e vendeve në ZEE mund të punojnë në MB dhe në vende të tjera të ZEE pa kufizim. Shtetasit e vendeve të tjera trajtohen sipas rregullave të imigracionit dhe zakonisht kanë nevojë për një leje pune për të filluar punë në MB. Lejet e punës janë të vlefshme për punë deri në një datë të caktuar. Disa rregullime për leje pune janë vetëm kategori imigracioni afatshkurtër ndërsa rregullime të tjera të lejes së punë mund t'u sigurojnë qëndrim (vendosje) të përhershëm në Mbretërinë e Bashkuar. Personi duhet

të caktohet për një pozicion specifik zakonisht me kohë të plotë dhe do të bëhet punonjës i një punëdhënësi të MB me të gjitha dispozitat përkatëse që lidhen me një kontratë punësimi në MB.

Vetëm një punëdhënës mund të aplikojë për leje pune.

Përrjashtime të detyrimeve për leje pune

Sipas rregullave të imigracionit një shtetas që nuk është nga ZEE i cili kërkon të hyjë për qëllim punësimi nuk ka nevojë për leje pune nëse kualifikohet sipas një prej kategorive të mëposhtme të imigracionit dhe nëse ka marrë leje hyrjeje paraprake në postën diplomatike britanike jashtë, kur është e nevojshme:

- o ata që vijnë në MB për të krijuar një biznes të ri ose për të ndërmarrë ose për t'ju bashkuar një biznesi ekzistues si partner ose drejtor ose si tregtar i vetëm
- o Ata që punojnë gjatë pushimeve të cilët ndërmarrin punësim si një pjesë e rastësishme e pushimeve të tyre
- o Ata që vijnë në MB sipas Programit të Migrantëve Tepër të Kualifikuar
- o Përfaqësues të firmave të huaja që kërkojnë të ngrejnë një degë ose filial në MB
- o Mësues dhe asistentë gjuhe sipas skemave të miratuara të shkëmbimit
- o Punëtorë sezonalë në kampe bujqësore sipas skemave të aprovuara
- o Doktorë dhe dentistë që janë të diplomuar nga një shkollë e njohur mjekësore ose dentare në MB dhe që do të kryejnë një Program Themelimi 2 vjeçar
- o Novatorët, investuesit, *au pairs*, punëtorët shtëpiakë, shkrimtarët, kompozitorët dhe artistët.

Ekzistojnë gjashtë rregullime të ndryshme të lejeve të punës:

1. Biznesi dhe tregtare

Rregullimet e biznesit dhe tregtare lejojnë punëdhënësit në Mbretërinë e Bashkuar të punësojnë persona nga jashtë Zonës Ekonomike Europiane (ZEE) për të plotësuar një vend vakant që ndryshe mund të plotësohet nga një punëtor rezident

2. Skema e trajnimit dhe përvojës në punë (TWES)

3. Sporte dhe Argëtim

Rregullimi i Skemës së Trajnimit dhe Përvojës në Punë (TWES) mundëson persona nga jashtë ZEE të fillojnë trajnim të bazuar në punë për një kualifikim profesional ose specializim, ose një periudhë përvojë punësimi

4. Praktika të studentëve

5. Marrëveshje të përgjithshme për tregtinë e shërbimeve (GATS)

Rregullimet e GATS lejojnë punëtorët e kompanive që ndodhen jashtë Bashkimit Europian (BE) të punojnë në Mbretërinë e Bashkuar me kontratë shërbimi që i jepet punëdhënësit të tyre nga një organizatë me qendër në Mbretërinë e Bashkuar.

6. Skema të bazuara në sektorë (SBS)

Skema e Bazuar në Sektorë (SBS) lejon punëdhënësin në këtë vend të rekrutojë persona nga jashtë ZEE për të plotësuar vende vakante që nuk ka mundur t'i plotësojë me punëtorë rezidentë. SBS bazohet në seksione specifike (të njohura si sektorë) të tregut të punës.

Aplikimet për leje pune trajtohen nga Lejet e Punës (MB), pjesë e Zyrës së Brendshme të Drejtorisë së Imigracionit dhe Kombësisë. Lejet e Punës (MB) zakonisht merren me aplikime brenda katër ose pesë ditësh.

Për pozicionin:

1. një përshkrim të detajuar pune për pozicionin

Për kandidatin:

1. Fotokopje të referencave të detajuara të punëdhënësit që mbulojnë 3 vjet të punësimit të kandidatit. Këto referenca duhet të kenë kokën e kompanisë në letër, të konfirmojnë datën e fillimit dhe të mbarimit të punësimit, titullin e punës dhe një shpjegim të detajuar të detyrave dhe përgjegjësisë të pozicionit së bashku me aftësitë teknike të nevojshme për rolin.
2. fotokopje të kualifikimeve të larta dhe/ose profesionale

3. Fotokopje të çdo leje pune të mëparshme që ka pasur kandidati
4. Fotokopje të pasaportës
5. CV
6. Hollësi të pagës dhe shpërblimeve të tjera që do të marrë kandidati
7. Hollësi të vendndodhjes/vendndodhjeve ku do të punojë kandidati në MB

Për çdo skemë të lejes për punë ka kërkesa të veçanta. Për hollësi për informacione, duhet të lexoni shënimet përkatëse udhëzuese.

<http://www.ukba.homeoffice.gov.uk/workingintheuk/workpermits/>

2) Sistemi i bazuar në pikë: Niveli 1 – Programi i Migrantëve Tepër të Kualifikuar (HSMP)

Sistemi i imigracionit i bazuar në pikë

Rregullimi i migracionit për punë në MB menaxhohet brenda kuadrit të sistemit të migracionit të bazuar në pikë, përfshirë një sistem migracioni për shtetas jo të BE-së që duan të punojnë, studiojnë ose trajnohen në Britani, i prezantuar në 2008. Sistemi ndahet në pesë nivele që përfshijnë migracion për tepër të kualifikuar, leje pune, studentë, punëtorë gjatë pushimeve dhe pothuajse të gjitha rrugët e tjera që lidhen me punësimin, studimin, biznesin, ose investimin.

Sistemi i ri i imigracionit do të zëvendësojë 80 rrugë aktuale që ekzistojnë tani. Çdo nivel do të ketë kushte të ndryshme, të drejta të ndryshme dhe kërkesa për hyrje për migrantët që dëshirojnë në MB.

Sistemi prezantohet në faza. Mbretëria e Bashkuar së fundmi ka dhënë informacion për Nivelin 1, niveli i parë që do zbatohet në fillim të 2008. Niveli 1 për migrantët tepër të kualifikuar, do të ndahet në katër nënkategori, duke përfshirë migrantë tepër të kualifikuar, sipërmarrës, investitorë dhe studentë të huaj universitarë të institucioneve arsimore të MB.

Struktura e pikëve

Çdo nivel i kërkon migrantit të arrijë një numër të mjaftueshëm pikësh për të fituar leje hyrjeje ose për t'u lejuar që të qëndrojë (qëndrim i përhershëm) në Mbretërinë e Bashkuar. Pikët do të jepen për kritere të ndryshme specifike për çdo nivel. Në nivelin 1 dhe 2, pikët do të jepen për kritere si moshë, paga e mëparshme ose paga e ardhshme dhe kualifikimet; një sistem i ngjashëm me Programin për Migrantë tepër të Kualifikuar (HSMP) që ka rezultuar shumë i suksesshëm.

Tier 1 (I përgjithshëm)- "punëtorë tepër të kualifikuar" është hartuar për të lejuar që persona tepër të kualifikuar të vijnë në Mbretërinë e Bashkuar për të kërkuar punë ose mundësi vetëpunësimi. Ndryshme nga lejet e punës ose skemat për personat e biznesit, nuk ju nevojitet ofertë punësimi ose plan i detajuar biznesi për të aplikuar për Nivelin 1 (I përgjithshëm)- punëtor tepër i kualifikuar. Kur aplikoni ju jepen pikë sipas kualifikimeve, fitimeve të mëparshme, përvojës në Mbretërinë e Bashkuar, moshës, gjuhës angleze dhe mjeteve financiare në dispozicion (fondeve).

MB do të fillojë të pranojë aplikime Niveli 1 (I përgjithshëm) në vende përveç Indisë në 2008. Deri atëherë, nëse jeni jashtë Mbretërisë së Bashkuar në një vend që nuk është India, mund të vazhdoni të aplikoni sipas Programit për Migrant tepër të kualifikuar: <http://www.ukba.homeoffice.gov.uk/workingintheuk/hsmp/>

(3) Skema për të Diplomuarit Ndërkombëtarë

Skema e të Diplomuarve Ndërkombëtarë filloi në 1 maj 2007 dhe zëvendësoi Skemën e të Diplomuarve në Shkenca dhe Inxhinieri. Skema ju lejon nëse jeni i diplomuar nga një vend jo anëtar në ZEE, që keni përfunduar studimet në Mbretërinë e Bashkuar, të keni akses punësimi ose vetëpunësimi në Mbretërinë e Bashkuar. Ju lejohet deri në 12 muaj në Mbretërinë e Bashkuar për të fituar përvojë pune. Nëse doni të qëndroni në Mbretërinë e Bashkuar përtej kësaj periudhë, do të duhet të aplikoni sipas një kategorie të re imigracioni.

<http://www.ukba.homeoffice.gov.uk/workingintheuk/igs/>

(4) Post Skema e lidhjeve Klinike ose vëzhguesit dentar

<http://www.ukba.homeoffice.gov.uk/workingintheuk/clinicalattachments/>

(5) Skema Skoceze e talenteve të rinj:

Të punuarit e Skemën Skoceze është pjesë e iniciativës së qeverisë skoceze për talentet e reja. Iniciativa inkurajon persona nga jashtë Mbretërisë së Bashkuar të vijnë të jetojnë dhe të punojnë në Skoci dhe i inkurajon gjithashtu ata që kanë lindur në Skoci të qëndrojnë për të filluar ose vazhduar karrierën e tyre atje. Nuk ka kufizime për llojin e punës që mund të bëni nëse ju jepet leje për të qëndruar në Skoci sipas skemës.

<http://www.ukba.homeoffice.gov.uk/workingintheuk/freshtalent/>

(6) Infermiere dhe mami të kualifikuara nga jashtë

Nëse vini në Mbretërinë e Bashkuar si infermiere e kualifikuar nga jashtë do t'ju jepet leje për të hyrë dhe qëndruar në Mbretërinë e Bashkuar për një periudhë maksimumi 18 muaj. Në përfundim të 18 muajve do të pritët që ju të largoheni nga Mbretëria e Bashkuar.

<http://www.ukba.homeoffice.gov.uk/workingintheuk/overseasqualifiednurses/>

(7) Skema Au pair

Skema *au pair* synon që t'ju sigurojë të rinjve nga disa vende mundësi për të ardhur në Mbretërinë e Bashkuar për kohë të shkurtër për të punuar për një familje anglishtfolëse. Pritet që të punoni deri në pesë orë në ditë për familjen anglishtfolëse. Ata do të sigurojnë për ju një dhomë dhe një pagë javore.

Më shumë informacion:

- Shoqata Ndërkombëtare e Au Pair: www.iapa.org
- Shoqata Britanike e Agjencive të Au Pair: www.bapaa.org.uk
- Faqe Interneti i Agjencisë Kufitare: <http://www.bia.homeoffice.gov.uk/workingintheuk/aupairs/whattoexpect/>

(8) Argëtuesit

<http://www.ukba.homeoffice.gov.uk/workingintheuk/entertainers/>

(9) Doktorë dhe dentistë pasuniversitarë

<http://www.ukba.homeoffice.gov.uk/workingintheuk/postgraduatoctorsanddentist/>

Për listën e plotë të të gjitha kategorive, kontrolloni: <http://www.ukba.homeoffice.gov.uk/workingintheuk/>

b. Sektorët e tregut të punës dhe mangësitë

Ka mangësi për punëtorë të kualifikuar brenda tregut të punës së rezidentëve. Prandaj jë punëdhënës mund të aplikojë për leje pune pa patur nevojë të provojë së pari që nuk mund të plotësojnë vendet vakante nga tregu i punës me rezidentë.

- Mangësi kualifikimi ka mundësi të ketë në Menaxherë me përvojë Mbetjesh, Menaxherë Logjistike/Kontrollues Trafiku, staf shitjesh, përshtatës (për automjete dhe fabrika), shoferë (mbledhje dhe specialistë automjetesh), mbledhës (riciklim), shkencëtarë dhe inxhinierë, sektor ndërtimi, shkencë dhe profesionistë teknologjie (asociuar), profesionistë mësimdhënieje dhe kërkimi, profesionistë biznesi dhe shërbimesh publike, profesionistë shëndeti dhe mirëqenieje sociale; profesionistë shëndeti
- Mangësi ka dhe në sektorë dhe profesione me më pak kualifikim si: sektori bujqësor, profesione shërbimi, sektori i ndërtimit dhe sektori i kujdesit shëndetësor; profesione që lidhen me zejtarë elementare, prodhim dhe ruajtje

c. Informacion dhe faqe interneti për të kërkuar punë

Departamenti për Punë dhe Pensione	http://www.dwp.gov.uk/	Informacion për çështje punësimi, taksa, numra të sigurimeve kombëtare, situatën e tregut të punës etj
Direkt për Punëkërkuessit	telefon: 0845 60 60 234	Vendet vakante më të fundit dhe ndihmë për të gjetur punë
Qendra e Punës Plus	http://www.jobcentreplus.gov.uk/JCP/Aboutus/Ouroffices/index.html Jobcentre Plus Secretariat: Level 1 Steel City House West Street Sheffield, S1 2GQ	Shërbim profesional, modern dhe falas nëpërmjet rrjetit të zyrave dhe qendrave të kontaktit të Britani
Departamenti për Biznes, Ndërmarrje dhe Reformë Rregullatore	http://www.berr.gov.uk/	Informacion për mundësi biznesi në MB
Directgov	http://www.direct.gov.uk/en/Employment/Jobseekers/LookingForWork/DG_10030134	Banka e të dhënave për të kërkuar punë
Portat e Punës	http://www.workgateways.com/search.php	Informacion për të punuar në MB; banka e të dhënave për të kërkuar punë
Portali European i Lëvizshmërisë së Kërkuesit	http://www.ec.europa.eu/eracareers/index_en.cfm	Vendet vakante të punës të grupuara sipas vendit dhe fushës së kërkimit
Faqe interneti për të kërkuar punë	http://www.jobsite.co.uk/ http://www.jobsearch.co.uk/ http://www.clickajob.co.uk/ http://www.newjobdirect.co.uk/ http://jobsearch.monster.co.uk/ http://www.jobs1.co.uk/ http://www.jobisjob.co.uk/	banka e të dhënave për të kërkuar punë sipas kategorisë dhe llojit të punës
Gazeta	Guardian Jobs: http://www.jobs.guardian.co.uk/ Daily newspaper: http://dailynewspaper.co.uk/ The Mirror: http://www.mirror.co.uk/ The Sun: http://www.thesun-uk.com/ The Economist: http://www.economist.co.uk/ Sunday Times: http://www.timesonline.co.uk/tol/news/ Sunday Mirror: http://www.sundaymirror.co.uk/	

4. Imigracioni për qëllime studimi

a. Kushtet e hyrjes dhe qëndrimit të studentëve

VIZA

Nëse do të vini të studioni për një periudhë maksimale prej 6 muajsh, mund të vini në MB si një **"student vizitor"** ose si një **"student"**. Nëse zgjidhni të vini si "student vizitor":

- Nuk ju lejohe të bëni ndonjë punë (dhe nëse është pjesë e një kursi)
- Nuk ju lejohe të aplikoni për më shumë kohë në MB, nëse shtyhen studimet

Nëse doni të vini në MB si "student" për më shumë se gjashtë muaj duhet të aplikoni për 'leje hyrjeje', nga ambasada britanike (Ambasadë, Komisioni i Lartë ose Konsullata e Përgjithshme) në vendin tuaj përpara se të udhëtoni në MB.

Jeni **shtetas që ka nevojë për vizë** nëse jeni nga një prej vendeve të mëposhtme:
Shqipëri, Bosnjë Hercegovinë, ish Republika Jugosllave e Maqedonisë, Mal i Zi dhe Serbi

Kërkesa për studentët

Shtetasit e vendeve që nuk janë në ZEE kanë nevojë për leje që të hyjnë në MB. Sipas sistemit të imigracionit të MB, kjo leje quhet "leje për hyrje". Kërkesat që duhen plotësuar nga një person që kërkon leje për hyrje në Mbretërinë e Bashkuar si student janë që ai ose ajo:

1. të jetë pranuar për një kurs studimi që ofrohet nga një organizatë të përfshirë në Departamentin e MB për Regjistrin e Arsimit dhe Kualifikimeve të Ofruesve të Arsimit dhe Trajnimit;
2. të jetë pranuar për një kurs studimi në:
 - një institucion të financuar shtetëror të arsimit të mëtejshëm ose të lartë (universitet) me të dhënat e regjistrimit dhe pjesëmarrjes që mund të gjenden në Agjencinë Kufitare të MB
 - një institucion të mirëfilltë arsimor privat; ose
 - një shkollë të pavarur me pagim tarife;
3. është në gjendje dhe synon të ndjekë ose:
 - Një kurs diplomimi me kohë të plotë të njohur në një institucion të financuar shtetëror të arsimit të mëtejshëm ose të lartë;
 - Një kurs gjatë ditëve të javës që përfshin pjesëmarrjen në një institucion të vetëm për minimumi 15 orë studim në javë të organizuar gjatë ditës për një lëndë të vetme ose lëndë që lidhen drejtpërdrejt, ose
 - Një kurs studimi me kohë të plotë në një shkollë të pavarur me pagesë tarife
4. nëse nën 16 vjeç, të jetë regjistruar në një shkollë të pavarur me pagesë tarife për një kurs studimi me kohë të plotë që plotëson kërkesat e Aktit të Arsimit 1944 dhe
5. synon të largohet nga Mbretëria e Bashkuar në përfundim të studimeve të tij/saj (përveç studentëve të diplomuar që synojnë të qëndrojnë për të punuar pasi të mbarojnë studimet, nëse nuk sponsorizohen nga qeveritë e tyre ose nga një agjenci ndërkombëtare bursash) dhe
6. nuk synon të angazhohet në biznes ose të fillojë punësim në MB, përveç punës me kohë të pjesshme ose në pushime që fillohet me miratimin e Sekretarit të Shtetit për Punësim, dhe
7. është në gjendje të përballojë koston e kursit dhe akomodimit dhe të mbajë veten dhe persona në ngarkim pa punuar ose u angazhuar në biznes ose pa kërkuar nga fondet publike

Kërkesat për "studentët vizitorë"

Nëse do të vini në Mbretërinë e Bashkuar si vizitor për të studiuar duhet:

- të kërkonte leje hyrjeje si student vizitor për një periudhë të kufizuar të përcaktuar nga ju dhe që nuk kalon gjashtë muaj;
- jeni pranuar në një kurs studimi që ofrohet nga një organizatë e përfshirë në departamentin për regjistrimin e fëmijëve, shkollave dhe familjeve të ofruesve të arsimit dhe trajnimit;
- të largoheni nga mbretëria e Bashkuar në përfundim të vizitës siç e përcaktoni vetë;
- të mbani dhe të paguani për akomodim për veten dhe persona në ngarkim pa ndihmën e fondeve publike; dhe
- të siguronit që ju dhe personat në ngarkim do të mbahen dhe akomodohen nga të afërm ose miq dhe nuk do të fillojnë punë; dhe
- të jeni në gjendje të përballoni koston e udhëtimit të kthimit ose më tej

Ju nuk duhet:

- të filloni punë në Mbretërinë e Bashkuar;
- të përfshiheni në biznes, të prodhoni mallra ose të ofroni shërbime brenda Mbretërisë së Bashkuar përfshirë shitjen e mallrave dhe shërbimeve direkt tek anëtarë të publikut;
- të studioni në një shkollë të financuar nga qeveria;
- të jeni fëmijë nën moshën 18 vjeç;
- të filloni punë me kohë të pjesshme (deri në 20 orë), ose të plotë; të merrni një vend punë stazhi (me pagë apo jo) si pjesë e kursit tuaj të studimit; ose
- të zgjasni qëndrimin në Mbretërinë e Bashkuar

Nëse jeni shtetas që ju nevojitet vizë, sigurohuni që të aplikoni për leje hyrjeje si student dhe jo si vizitor. Vizitorët që janë shtetas që kërkojnë vizë nuk lejohet të shtyjnë qëndrimin si studentë kur përfundon vizita, kështu që sigurohuni që të aplikoni për llojin e duhur të lejes se hyrjes në radhë të parë.

Duhet të siguroheni që keni dokumentet dhe informacionin e nevojshëm përpara se të aplikoni për leje hyrjeje ose të udhëtoni në MB në Misionin britanik jashtë:

- Formularë aplikimi (Formulari VAF1) për vizë ose leje hyrjeje
- pasaportën tuaj
- një fotografi pasaporte të kohëve të fundit për veten tuaj
- pagesën përkatëse të paguar në monedhën vendase
- dokumente që tregojnë se plotësoni kërkesat e hyrjes
- Një letër pranimit në kurs (përveçse për studentët e ardhshëm)

Letra duhet të tregojë titullin e kursit, kohëzgjatjen e kursit (datat e fillimit dhe mbarimit) dhe të konfirmojë që keni plotësuar kërkesat e hyrjes për kursin dhe që jeni vlerësuar të aftë nga ana akademike për ta ndjekur kursin

- Vërtetim që mund të paguani tarifën e kursit dhe të mbështesni veten dhe familjen (nëse vlen);

Ky mund të përfshijë vërtetim të sponsorizimit të qeverisë, një letër nga një sponsor që konfirmon që mund t'ju mbështesin si dhe vërtetim që mund ta bëjnë këtë dhe/ose deklaratat tuaja bankare. Informohuni nga Misioni Britanik në vendin tuaj për të pyetur sa deklarata bankare ju duhen

- Vërtetim për akomodim

Edhe pse rregullat e imigracionit nuk u kërkojnë studentëve të pashoqëruar të tregojnë që akomodimi është rregulluar, vendi juaj i studimit mund t'ju ketë dhënë informacion për disponueshmërinë e tij pse mund të rregullojë akomodimin tuaj

Leje e hyrjes, ose vula që nëpunësi i migracionit ju jep kur mbërrini në MB, tregon nëse duhet të regjistroheni tek policia apo jo. Shtetas të ZEE dhe zviceranë dhe të Komunuelthit nuk kanë pse të regjistrohen. Leja juaj e hyrjes ose vula ndoshta do t'ju tregojë të regjistroheni në polici nëse:

1. jeni 16 vjeç e lart;
2. synoni të qëndroni në MB për më shumë se gjashtë muaj si student

Nëse leja e hyrjes ose vula thotë që të regjistroheni, bashkëshortit/bashkëshortes tuaj, partnerit civil ose fëmijës ka mundësi t'u jepet një leje hyrjeje ose vulë që ju thotë të regjistrohen dhe ata gjithashtu.

APLIKIM PËR T'U PRANUAR PËR STUDIME

Për të parë sesi kualifikimet tuaja krahasohen me kualifikimet britanike, kontaktoni Zyrën e Këshillit Britanik lokale ose shkruajini Qendrës Kombëtare të MB për Informacionin për Njohjet Akademike (NARIC). Çdo kolegji dhe universitet i veçantë merr vendimin e tij për kualifikimet ndërkombëtare që pranon, por duke kontaktuar me Këshillin Britanik ose NARIC mund të merrni një ide të përgjithshme për çfarë mund të prisni.

Kërkesat e hyrjes

Kërkesat standarde të pranimit për institucionet të larta arsimore në Angli, Uells dhe Irlandën e Veriut janë dy ose tre nivele A GCE si dhe GCSEs, ose ekuivalente. Për institucione në Skoci, standardi është katër ose pesë nivele më të larta ose ekuivalente. Institucionet mund të kërkojnë kualifikime shtesë nëse dëshirojnë, por këto janë kryesore. Në të gjitha institucionet duhet të dëshmoni njohuritë në gjuhën angleze (psh me pikë të mira në testin IELTS) nëse nuk është gjuha amtare. Mund të filloni studimet në MB me një program themelimi dhe shumë kurse të bazuara në punë ofrojnë rrugë nëpërmjet studimit të nivelit të diplomimit.

Procesi i aplikimit

Për të aplikuar për kurse diplomimi me kohë të plotë, kurset e themelimit (anglisht vetëm), HDNs dhe Diploma e Kurseve të Arsimit të Lartë, vetëm bëni një adresim të vetëm nëpërmjet procesit të pranimeve.

Ky shërbim kryesisht ofrohet nga UCAS (Sistemi i Pranimeve në Universitete dhe Kolegje). Të gjitha universitetet e MB (përveç Universitetit të hapur), shumica e kolegjeve dhe instituteve të arsimit të lartë dhe institucionet FE që ofrojnë kurse të arsimit të lartë, janë anëtarë të UCAS.

Skema UCAS mbulon rekrutimin e studentëve të MB, BE-së dhe ndërkombëtarë për të gjitha pikat e hyrjes (pra përfshin pranimin me kredite) për programe të nivelit parauniversitar. Mund të aplikoni për deri në gjashtë institucione në një formular të vetëm aplikimi UCAS. UCAS tani inkurajon fuqishëm aplikimet *online* nëpërmjet shërbimit "Apliko"

Më shumë informacion:

Guidë: Studimi dhe jetesa në Mbretërinë e Bashkuar 2007-08, Këshilli Britanik;

http://www.educationuk.org/downloads/study_live_uk.pdf

UKCOSA: Këshilli për Arsimin Ndërkombëtar <http://www.ukcosa.org.uk/>

PUNA E STUDENTIT

Rregulla të veçanta për studentë bëjnë të mundur që të punoni ndërkohë që jeni me studime. Mundësitë që ofrohen përfshijnë punën me kohë të pjesshme ose gjatë pushimeve, si dhe vende pune gjatë kursit në dy vende të ndryshme. Gjithashtu mund të jeni në gjendje të qëndroni më shumë në MB në përfundim të kursit për trajnim ose përvojë pune, ose sipas një skeme të re të prezantuar nga qeveria për të diplomuarit, në disa kurse të shkencave fizike, matematikës dhe inxhinierisë.

Përpara se të kërkonte një punë MB, duhet të kontrolloni që vula ose pulla në pasaportë ju lejon që të punoni. Studentët me vulën/pullën në pasaportë lejohet të punojnë sipas kushteve të mëposhtme:

- nuk mund të drejtoni biznesin tuaj, të vetëpunësoheni, të ofroni shërbime si sportist profesional ose argëtues, ose të ndiqni një karrierë duke marrë një pozicion të përhershëm me kohë të plotë;
- paratë që shpresoni të bëni duke punuar me kohë të pjesshme ose në pushime janë pjesë e aplikimit tuaj të imigracionit. Duhet të tregoni që mund të përballoni koston e studimit dhe jetesës në MB pa punësim ose ndihmë financiare nga shteti
- Gjatë kohës së studimeve do të lejoheni vetëm të punoni për maksimumi 20 orë në javë

Më shumë informacion:

http://www.ukcosa.org.uk/files/pdf/info_sheets/working_during_study.pdf

dhe http://www.ukcosa.org.uk/student/information_sheets.php#working_during_study

b. Bursa universitare dhe pasuniversitare

Informacioni për grante dhe bursa mund të merret nga Ministria e Arsimit ose Departamenti i Arsimit në vendin e origjinës. Megjithatë, zyra juaj e Këshillit Britanik mund t'ju japë detaje të dhënies së bursa në dispozicion përfshirë ato që ofrohen nga vetë institucionet e MB.

Skemat kryesore të bursave në dispozicion për studentët ndërkombëtarë përfshijnë:

- Bursat British Chevening <http://www.chevening.com/>
- Plani i Bursave dhe Bursat e Komunelthit (CSFP) <http://www.csfp-online.org/>
- Skema e Bursave të Përbashkëta <http://www.dfid.gov.uk/funding/sharedscholarship.asp>
- Skema e Bursave për Kërkim për Studentë të Huaj (ORSAS) <http://www.orsas.ac.uk/>

Konkurrenca për bursa dhe grante studimi në MB është shumë e madhe. Shumica e organizatave që ofrojnë grante do të këmbëngulin që të plotësoni disa kriterë shumë të rrepta. Nëse nuk i plotësoni kërkesat për një grant atëherë aplikimi juaj nuk do të konsiderohet.

Kur të aplikoni, mos harroni

- ju duhet të aplikoni për grantin një vit përpara se të fillojë kursi; afati varion kështu që duhet të kontrolloni që ta dini cili është afati përpara se të aplikoni;
- aplikimi juaj duhet të jetë i saktë dhe konciz; duhet të përdorni formularin e aplikimit, nëse ka një të tillë, të në organizimi që ofron grante,
- Shumica e organeve që ofrojnë grante do t'ju japin vetëm sasi të vogla parash që nuk do të mbulojnë gjithë koston e kursit

Kualifikimi. Për bursat duhet të merrni një diplomë pasuniversitare ose kurs Masteri në MB që zgjat deri në një vit. (Ndonjëherë bursat jepen dhe për kurse më të shkurtra). Në mënyrë ideale, duhet të jeni tashmë në një karrierë të caktuar.

Aplikimet: Kontaktoni Këshillin Britanik ose Ambasadën Britanike ose Komisionin e lartë në vendin tuaj për detaje. Kur të aplikoni duhet të jeni rezident në vendin tuaj të origjinës. Kandidatët përzgjidhen nga ambasadat britanike dhe komisionet e larta jashtë vendit.

Skemat e Bashkimit European

Erasmus Mundus: Programi Erasmus Mundus ofron bursa për studentë me cilësi të jashtëzakonshme për të ndjekur një kurs Masteri Erasmus Mundus në dy ose më shumë universitete europiane. Skema është e hapur për studentë në mbarë botën, me përjashtim të atyre nga Zona Ekonomike Europiane.

http://ec.europa.eu/education/programmes/mundus/index_en.html

Dritarja e Bashkëpunimit të Jashtëm Erasmus Mundus: (vlen për studentë dhe stafin akademik nga vende të pranueshme në Afrikë, Azi, Karaibe, Europë Lindore, Amerikë Latine, Paqësor dhe Ballkan Perëndimor). Dritarja e Bashkëpunimit të Jashtëm Erasmus Mundus mbështet shkëmbimin e studentëve, kërkuesve dhe stafit akademike ndërmjet institucioneve në vende europiane dhe të treta të pranueshme për periudha nga 1 deri në 34 muaj.

<http://eacea.ec.europa.eu/extcoop/call/index.htm>

Kolegjet dhe universitetet e MB-së

Shumë institucione të arsimit të lartë në MB kanë numër të kufizuar bursash për studentë ndërkombëtarë. Megjithatë, ato mund të kufizohen për studentë që studiojnë lëndë të veçanta ose nga vende të caktuara. Kontaktoni institucionin ku studioni për të parë nëse jeni i pranueshëm.

c. Lista e universiteteve dhe kolegjeve kryesore

- **Universiteti** i Oksfordit: <http://www.ox.ac.uk/>
- **Universiteti** i Kembrixhit (Kembrixh, Angli, MB) : <http://www.cam.ac.uk/>
- Shkolla Ekonomike dhe Politike e Londrës : <http://www.lse.ac.uk/>
- Kolegji Universitar Londër: <http://www.ucl.ac.uk/>
- Universiteti Loughborough: <http://www.lboro.ac.uk/>
- Universiteti i Bristolit (Bristol, Angli, MB) : <http://www.bristol.ac.uk/>
- Universiteti i Edinburg (Edinburgh, Scotland, UK) : <http://www.ed.ac.uk/>
- **Royal Holloway**, Universiteti i Londrës: <http://www.rhul.ac.uk/>
- Universiteti **Aston** : <http://www.aston.ac.uk/>
- Kolegji **King Londër** : <http://www.kcl.ac.uk/>
- **SOAS**, Universiteti i Londrës: <http://www.soas.ac.uk/>
- Universiteti i Lancasterit: <http://www.lancs.ac.uk/>
- **Universiteti** i Shefildit (Shefield, Angli, MB) : <http://www.shef.ac.uk/>
- Universiteti i **Manchester** : <http://www.manchester.ac.uk/>

- [Universiteti i Glasgow](http://www.gla.ac.uk/) : <http://www.gla.ac.uk/>
- Queen's Belfast : <http://www.qub.ac.uk/>
- Universiteti i [Birminghamit](http://www.bham.ac.uk/) : <http://www.bham.ac.uk/>
- [Universiteti i Kent at Canterbury](http://www.kent.ac.uk/) : <http://www.kent.ac.uk/>
- [Universiteti i Stirling](http://www.external.stir.ac.uk/) : <http://www.external.stir.ac.uk/>
- [Universiteti i Surrey](http://www.surrey.ac.uk/) : <http://www.surrey.ac.uk/>
- [Universiteti i Strathclyde](http://www.strath.ac.uk/) : <http://www.strath.ac.uk/>
- [Universiteti i Uellsit - Bangor](http://www.bangor.ac.uk/) : <http://www.bangor.ac.uk/>
- Universiteti [Swansea](http://www.swansea.ac.uk/) : <http://www.swansea.ac.uk/>
- Universiteti i Londrës (Londër, Angli, MB) : <http://www.city.ac.uk/>

d. Faqe interneti të nevojshme për të studiuar në MB

Departamenti i Novacionit, Universitetet dhe Kualifikimet	http://www.dfes.gov.uk/providersregister/ http://www.dcsf.gov.uk/recognisedukdegrees/	Informacion për diploma të njohura në MB Regjistri i ofruesve të trajnimit dhe arsimit
Arsimimi në MB	www.educationuk.org http://www.educationuk.org/downloads/study_live_uk.pdf	Eksplorimi i mundësive të studimit në MB Informacion për të studiuar dhe jetuar në MB
UCAS: Shërbimet e pranimit në universitete dhe kolegje	www.ucas.com/apply/index.html Rosehill, New Barn Lane, Cheltenham, Gloucestershire GL52 3LZ, Phone +44 (0)870 112 2211 (aplikime)	Aplikime <i>online</i> për t'u pranuar në kolegjet dhe institucionet e MB
	http://www.ucas.com/students/startapplication/faqs/	Pyetje të shpeshta: Procedura e Aplikimit
Agjencia Kufitare e MB	http://www.ukba.homeoffice.gov.uk/studyingintheuk/ www.ukvisas.gov.uk	
Këshilli i MB për Çështje të Studentëve Ndërkombëtarë (UKCOSA)	UKCOSA, 9–17 St Albans Place, London N1 0NX, Telephone advice service available 1.00 p.m. to 4.00 p.m. +44 (0)20 7107 9922. www.ukcosa.org.uk http://www.ukcosa.org.uk/student/information_sheets.php	Fletë informacioni: Akomodim për studentë ndërkombëtarë; përgatitja për studime në MB; gjendja e mirë shëndetësore; të studiuarit në MB; mbështetja financiare
Sigurimi	Shoqata e Siguruesve Britanikw 51 Gresham Street, London EC2V 7HQ, Tel: +44 (0)20 7600 3333, Fax +44 (0)20 7696 8999, Faqe interneti: www.abi.org.uk	Informacion për çështje siguracioni dhe statusin e shoqërive të sigurimit
Të mësuarit për Këshillin Britanik	http://www.britishcouncil.org/learning http://www.britishcouncil.org/learning-funding-your-studies.htm http://www.britishcouncil.org/learning-funding-	Ndihmon për të gjetur financim për kurse, nëpërmjet skemës së bursave dhe adresave e

	your-studies.htm www.britishcouncil.org/learning-education-information-sheets	miratuara të internetit
Kurse të gjuhës angleze	Arsimimi MB: www.educationuk.org/english Mësimi i Anglishtjes, Shërbim i BBC në Botë: www.bbc.co.uk/worldservice/learningenglish Anglishtja në MB: http://englishuk.com Sistemi Ndërkombëtar i Testimit të Gjuhës Angleze www.ielts.org Mësoni anglisht: www.learnenglish.org.uk Sigurimi i cilësisë: www.britishcouncil.org/accreditation	Anglishtja në guidën e MB-së: Informacion për kurse në gjuhën angleze

5. Qëndrimi në MB

Kategoritë:

- **Leje e kufizuar qëndrimi:**

